



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr. 274/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik: “Beni-Com” SH.P.K; “Linda”SH.P.K.; “Euro Infrastruktura” – Obiliq, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë: OE “Rexha” SH.P.K. – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i parkut rekreativ-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës” me nr. të prok: 616-19-7632-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK - Prishtinë”, më datën: 12.06.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht e bazuar ankesa e grupit të operatorëve ekonomik: “Beni-Com” SH.P.K, “Linda”SH.P.K., “Euro Infrastruktura” – Obiliq, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i parkut rekreativ-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës” me nr. të prok: 616-19-7632-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK - Prishtinë”.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i parkut rekreativ-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës” me nr. të prok: 616-19-7632-5-1-1, të iniciuar nga AK KK - Prishtinë, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e grupit të operatorëve ekonomik ankues: “Beni-Com” SH.P.K, “Linda” SH.P.K., “Euro Infrastruktura” – Obiliq, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet grupi i operatorëve ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Grupi i operatorëve ekonomik ankues: “Beni-Com” SH.P.K; “Linda”SH.P.K., “Euro Infrastruktura” – Obiliq, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 01.05.2020 me nr. 274/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i parkut rekreativ-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës” me nr. të prok: 616-19-7632-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK - Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 52, 59 dhe nenin 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 12.05.2020, ka autorizuar ekspertet shqyrtuese të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertet shqyrtuese të prokurimit në raportin e dt: 19.05.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqarojnë si në vijim:

Sqarim hyrës: Komuna e Prishtinës gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është punë, me vlerë të madhe. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës. Kundër të njëjtit propozim parashtruesi i ankesës ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim tek AK- Komuna e Prishtinës, me pretendimet e njëjta ankimore si në OSHP, përderisa AK,

me datën 23.04.2020 përmes vendimit ka refuzuar kërkesën si të pabazuar të OE “Beni Com” në konsorcium me OE “Linda”, OE “Euro Infrastruktura”.

Lidhur me pretendimin e parë të OE ankues “Beni Com”, “Linda”, “Euro Infrastruktura” se AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së sepse gjatë administrimit të procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i parkut rekreativ-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës” nuk ka luajtur rol aktiv që të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. OE ankues thotë se kjo ka ndodhur pasi gjatë vlerësimit të tenderëve nuk ka respektuar kërkesat e vendosura të dosjes së tenderit, me këtë rast edhe pse ka shpallur vendim më datë 31.01.2020, ku fitues e shpallë OE “Beni Com”, “Linda”, “Euro Infrastruktura” si fitues me çmimin prej 411,095.01 Euro, kurse pas ri-vlerësimit të tenderëve e shpall fitues OE “Rexha” SH.P.K. i cili ka ofertuar me çmim prej 473,369.61 euro, duke qenë dukshëm më i shtrenjtë. Pra, me çmim më të lartë prej 62,274.94 euro. Për këtë pretendim, OE ankues vazhdon të pretendoj se rekomandimi për kontratë i OE me çmim më të shtrenjtë prej 62,274.94 euro paraqet mos shfrytëzim të drejtë të fondeve publike dhe burimeve publike.

Përgjigje në pretendimin e parë:

Për këtë pretendim të OE ankues, ekspertet shqyrtuese sqarojnë se AK fillimisht e kishte rekomanduar për kontratë OE ankues duke publikuar njoftimin për dhënie të kontratës me datë 31.01.2020. Mirëpo, OE “Rexha” si palë e pa kënaqur me vendimin e AK-së paraqet kërkesë për ri shqyrtim të vendimit pranë AK-së, kurse autoritet kontraktues me datë 07.02.2020 e aprovon kërkesën e OE “Rexha” si të bazuar, duke e anuluar njoftimin për dhënie të kontratës. Arsytet e aprovimit të kërkesës për ri shqyrtim të OE “Rexha” dhe eliminimin nga gara të OE ankues “Beni Com”, “Linda”, “Euro Infrastruktura” ishin:

- OE ankues “Beni Com”, “Linda”, “Euro Infrastruktura” nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, punë për ndërtim dhe rregullim të parqeve, shesheve dhe hapësirave tjera publike në 3 (tri) vitet e fundit në vlerë minimale prej 800.000,00€.

- Hartuesi i një pjese të projektit-statikës Safet Lipovica është punonjës i OE “BENI COM”, që dëshmohej në pasqyrat e trustit të dorëzuara nga vet OE. Bazuar në këto dëshmi, sipas dispozitave ligjore të LPP (neni 1.75) dhe Kodit Etik të Prokurimit (neni 5.4 dhe 5.5), këtu kemi të bëjmë me konflikt interesi...

Me 17.04.2020 AK publikon njoftimin për dhënie duke rekomanduar OE “Rexha” me çmim prej 473,369.61€.

Ekspertet shqyrtuese pas shqyrtimit dhe analizimit të kontratave të grupit të OE ankues “Beni Com”,

“Linda”, “Euro Infrastruktura” dhe kërkesave të përcaktuara në dosje të tenderit, e të cilat gjenden në platformën e e-Prokurimit, vlerëson se tek “seksioni II Fleta e të dhënave të tenderit”, më saktë tek “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1&9.2 – është kërkuar:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale		Kapaciteti teknik dhe profesional: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses	Dëshmia e kërkuar dokumentare
	9.1	kontrata te ngjashme, punë për ndërtim dhe rregullim te parqeve,	1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar
	9.2	shesheve dhe hapësirave tjera publike, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 800.000,00 euro SHENIM Nëse tenderuesi është grup i OE-it lideri i grupit duhet te plotësojë 60 % te vlerës se referencave.	Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve.

Kurse, grupi i OE ankues “Beni Com”, “Linda”, “Euro Infrastruktura” për këtë kërkesë të dosjes së tenderit ka bashkëngjitur kontrata me referenca dhe fatura me fletë pagesë të bankës për autoritetet kontraktuese. Mirëpo, duke u bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit sikurse në pikën 9.1&9.2 të FDT, ekspertet shqyrtuese kanë bërë identifikimin e kontratave, ku të gjitha kontratat kanë të bëjnë me “shtrimin e asfaltit” dhe nuk kanë të bëjnë me rregullim të parqeve apo të natyrës së ngjashme. Megjithatë, edhe nëse i konsiderojmë këto kontrata sipas kërkesës të përcaktuar në pikën 9.1&9.2 të FDT, përsëri OE ankues nuk e plotëson kriterin e kontratave të realizuara në shumë prej 800,000.00 euro gjatë 3 viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Ekspertet shqyrtuese sqarojnë se kërkesa e AK përcakton që kontratat duhet të dëshmohen me referenca apo certifikata për kryerjen e punëve, si dhe duhet të jenë brenda 3 viteve, që nënkupton nga data 09.10.2016 deri me datë 08.10.2019. Kurse, OE ankues ka bashkëngjitur kontrata të cilat ishin para datës 09.10.2016. Ndërsa, pas shqyrtimit të këtyre kontratave të cilave i janë bashkëngjitur referencat ose certifikatat për kryerje te punëve të OE ankues konform kërkesës së AK (gjatë 3 viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë), rezulton që kontratat konform kërkesës së dosjes së tenderit janë si në tabelën në vijim:

Nr.	Titulli i kontratës	Data e kontratës	Prej datës 09.10.2016 deri me 08.10.2019
-----	---------------------	------------------	--

1	Kontrate shtese - Asfaltimi i rrugëve në Majac	11.11.2016	3,447.49
2	Asfaltimi i rrugës Podujeve - Livadice dhe ndërtimi i Urës	09.12.2016	28,550.75
3	Asfaltimi i disa rrugëve ne lagjet Krasniqi dhe Kosumi	20.12.2016	47,247.64
4	Asfaltimi i rrugës Pakashtice – Qenoge	13.10.2017	316,192.04
5	Asfaltimi i rrugëve rurale pjesa e III-të – Obiliq	08.12.2017	52,216.02

447,653.94

Ndërsa, sa i përket disa faturave dhe fletë pagesa të bankës të cilat OE “Beni Com” Sh.p.k. i ka bashkangjitur në dosje të tenderit, ekspertet shqyrtuesë vlerësojnë se këto fatura me fletë pagesa nuk janë konform kërkesës së përcaktuar në dosje të tenderit sepse AK ka kërkuar një listë të kontratave të realizuara, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve. Andaj, pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë të OE ankues “Beni Com”, “Linda”, “Euro Infrastruktura” se AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së duke mos i trajtuar në mënyrë të barabartë dhe duke vepruar në mënyrë jo të drejtë dhe jo diskriminuese duke anuluar vendimin e datës 31.01.2020 me të cilin AK e kishte shpallur fitues grupin e OE “Beni Com”, “Linda”, “Euro Infrastruktura”, me arsyetimin se përveç që nuk plotëson si lider 60% të punimeve të ngjashme, ka të punësuar edhe një punonjës inxhinier Safet Lipovica që ka marrë pjesë në një aktivitetin e prokurimit me numër 616 118 094 221 dhe të njëjtin e ka quajtur konflikt interesi. OE ankues vazhdon të pretendoj se OE i rekomanduar për kontratë “Rexha” Sh.p.k. i cili në tri vitet e fundit 2016-2017-2018 ka paraqitur punëtorin inxhinier Naser Surdulli arkitekt, i cili po ashtu ka punuar në të njëjtin aktivitet të prokurimit me punonjësin e OE “Beni Com”. Pra, në të njëjtin aktivitet prokurimi me numër 616 118 094 221 kanë qenë të angazhuar inxhinier Safet Lipovica dhe inxhinier Naser Surdulli, ku ky i fundit ka qenë i punësuar pranë OE “Rexha” Sh.p.k. në vitet 2016, 2017 dhe 2018. OE ankues pretendon se lidhur me këta dy inxhinier, AK ka përdor standarde të dyfishta duke mos i trajtuar në mënyrë të barabartë këta dy operator ekonomik.

Përgjigje në pretendimin e dytë

Ekspertet Shqyrtuese sqarojnë se pretendimi i OE ankues lidhur inxhinierët Safet Lipovica dhe Naser Surdulli, ky pretendim është i bazuar sepse në vendimin e AK-së të datës 07.02.2020 ku janë bashkangjitur dokumentet e hartimit të projektit, më saktë tek shtojca me emrin “vendimi i projektuesit” shihet që Safet Lipovica dhe Naser Surdulli kanë punuar në të njëjtin projekt. Konkretisht, Safet Lipovica në cilësi të inxhinierit të ndërtimtarisë për fazën e strukturës, kurse Naser Surdulli në cilësi të inxhinierit të arkitekturës. Të dy inxhinierët, Safet Lipovica dhe Naser Surdulli kanë punuar në hartimin e projektit

në fjalë që ka të bëjë me aktivitetin e prokurimit me numër 616-18-094-2-2-1. Kurse, në realizim të projektit apo si fazë e dytë, është ky aktivitet i prokurimit “Ndërtimi i parkut rekreativ-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës” me numër 616-19-763-5-1-1.

Sa i përket pretendimit të tretë ankimor të grupit të operatorëve ekonomik ankues “Beni Com”, “Linda”, “Euro Infrastruktura” se AK ka shkelur nenin 52 të LPP-së duke diskualifikuar grupin e OE ankues “Beni Com”, “Linda”, “Euro Infrastruktura” me arsyetimin se nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se kanë përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, punë për ndërtim dhe rregullim të parqeve, shesheve dhe hapësirave publike në 3 vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë në vlerë minimale 800,000.00 euro, duke qenë se tenderuesi është grup, lideri i grupit duhet të plotësojë 60% të vlerës së referencave. Për këtë pretendim, grupi i OE ankues shton se kontrata të ngjashme (hapësirave publike), operatori Beni Com ka përfunduar rrugë si lider i punimeve:

- “Rregullimi i qendrës së qytetit faza 2 segmenti 1.2.3” – lokacioni i këtij projekti është sheshi para komunës së Ferizajt në vlerë 243,607.53 euro, bashkëlidhur gjeni raport për projektin Nr.05 i datës 07.08.2018 nga AK Komuna e Ferizajt, si dhe fotot e vendit të ngjarjes së këtij projekti.

- “Asfaltimi i rrugës te Xhamia në Podujevë me infrastrukturë përcjellëse, ndriçim publik, kanalizim fekal, kanalizim atmosferik, rrjeti i ujësjellësit, sinjalizim horizontal e vertikal, urën mbi lumin Llap afër Kompleksit “Malësia” – lokacioni i këtij projekti është rreth lumit Llap në qendrën e qytetit të Podujevës në vlerë prej 293,871.53 euro, bashkëlidhur gjeni raportin preliminar i pranimit teknik të punëve të kryera i datës 17.12.2019 nga AK Komuna e Podujevës, si dhe fotot e vendit të ngjarjes së këtij projekti.

Në vazhdim të pretendimit të njëjtë, grupi i OE ankues pretendon se sipas llogaritjeve të këtyre dy aktiviteteve të prokurimit, OE “Beni Com” Sh.p.k. ka të përfunduara si lider vlerën e punimeve 537,476.06 euro. E që sipas dosjes së tenderit duhet ti ketë 60% të punimeve si lider i grupit të OE që në vlerë i bie se duhet të ketë 480,000.00€ punime me kontrata të ngjashme.

Përgjigje në pretendimin e tretë

Ekspertet shqyrtuese pas shqyrtimit të këtij pretendimi ankimor dhe dokumentit të datës 07.08.2018 të nxjerr nga KK Ferizaj lidhur me prerjen e punimeve për projektin me titull “Rregullimi i qendrës së qytetit faza II-të – Segmenti 1, 2 dhe 3 – projekt tre vjeçar”, ku OE ankues pretendon se kjo kontratë është në vlerë prej 243,607.53 euro, ekspertet vlerësojnë se për këtë projekt mungon referenca ose certifikatat për kryerje të punëve.

Kurse, sa i përket pretendimit për kontratën me titull “Asfaltimi i rrugës te Xhamia në Podujevë me infrastrukturë përcjellëse, ndriçim publik, kanalizim fekal, kanalizim fekal, kanalizim atmosferik, rrjeti

i ujësjetës, sinjalizim horizontal e vertikal, urën mbi lumin Llap afër Kompleksit “Malësia” në shumë prej 293,871.53 euro, ekspertet shqyrtuese i kanë shqyrtuar pagesat të cilat gjenden në platformën e e-Prokurimit, ku gjenden këto pagesa:

Nr. i Faturës	Dt. e Faturës	Përshkrimi	Vlera e Faturës
64-220-001-17	04.12.2017	me fletë pagesë të bankës	34,051.91
19-220-001-18	16.05.2018	me fletë pagesë të bankës	63,132.18
23-220-001-18	08.06.2018	me fletë pagesë të bankës	54,066.66
35-220-001-18	18.09.2018	me fletë pagesë të bankës	50,066.36
44-220-001-18	07.11.2018	me fletë pagesë të bankës	62,369.45
50-220-001-18	10.12.2018	me fletë pagesë të bankës	64,236.88
			327,923.44

Pra, faturat dhe fletë pagesat e cekura si më lartë, edhe pse shihet që kanë të bëjnë me projektin në KK Podujevë, të njëjtat nuk e plotësojnë kriterin e dosjes së tenderit sepse OE ankues edhe pse pretendon që i ka bashkëlidhur raportin preliminar të pranimit teknik të punëve të kryera të datës 17.12.2019, ekspertet shqyrtuese nuk e kanë hasur këtë dokument. Andaj, ky pretendim është i pa bazuar.

Ndërsa sa i përket pretendimit të katërt ankimor të grupit të operatorëve ekonomik ankues “Beni Com”, “Linda”, “Euro Infrastruktura” se AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së duke e shpallur fillimisht fitues grupin e OE ankues dhe duke e konsideruar si grup më të përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët në këtë aktivitet të prokurimit dhe për këtë arsye konsiderojmë se AK ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së.

Përgjigje në pretendimin e katërt

Ekspertet Shqyrtuese vlerësojnë se autoriteti kontraktues ka bërë ekzaminimin e tenderëve konform kërkesave të përcaktuara në kontratë kur ka eliminuar nga gara grupin e OE ankues sepse të njëjtit nuk përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit, konkretisht pikën 9.1&9.2 të dosjes së tenderit. Andaj, ky pretendim i grupit të operatorëve ekonomik ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e pestë të grupit të operatorëve ekonomik ankues “Beni Com”, “Linda”, “Euro Infrastruktura” se AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së duke mos e shpërblyer me kontratë grupin e OE ankues, i cili ka ofertuar me vlerën më të ulët në këtë aktivitet të prokurimit.

Përgjigje në pretendimin e pestë

Ekspertet Shqyrtuese sqarojnë se neni 60 i LPP-së përcakton që autoriteti kontraktues do t’ia jap

kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët ose tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji. Në rastin konkret, grupi i OE ankues nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit edhe pse ka ofertën me çmimin më të lirë, që do të thotë se AK ka vepruar konform nenit 60 të LPP-së.

Mendimi i ekspertëve shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertet shqyrtuese i propozojnë panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, ndërsa të vërtetohet njoftimi i AK-së për dhënie të kontratës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit me datën 19.05.2020 ka njoftuar palët me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 19.05.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertëve shqyrtuese.

Operatori Ekonomik, me datë: 22.05.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertëve shqyrtuese.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 12.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertëve shqyrtuese të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE ankues “Beni-Com” SH.P.K; “Linda” SH.P.K.; “Euro Infrastruktura” – Obiliq se AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së sepse gjatë administrimit të procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i parkut rekreativ-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës” nuk ka luajtur rol aktiv që të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. OE ankues thotë se kjo ka ndodhur pasi gjatë vlerësimit të tenderëve nuk ka respektuar kërkesat e vendosura të dosjes së tenderit, me këtë rast edhe pse ka shpallur vendim më datë 31.01.2020, ku fitues e shpallë OE “Beni Com”, “Linda”, “Euro Infrastruktura”

si fitues me çmimin prej 411,095.01 Euro, kurse pas ri-vlerësimit të tenderëve e shpall fitues OE “Rexha” SH.P.K. i cili ka ofertuar me çmim prej 473,369.61 euro, duke qenë dukshëm më i shtrenjtë. Pra, me çmim më të lartë prej 62,274.94 euro. Për këtë pretendim, OE ankues vazhdon të pretendoj se rekomandimi për kontratë i OE me çmim më të shtrenjtë prej 62,274.94 euro paraqet mos shfrytëzim të drejtë të fondeve publike dhe burimeve publike.

Paneli Shqyrtues sqaron se AK fillimisht e kishte rekomanduar për kontratë OE ankues duke publikuar njoftimin për dhënie të kontratës me datë 31.01.2020. Mirëpo, OE “Rexha” si palë e pa kënaqur me vendimin e AK-së paraqet kërkesë për ri shqyrtim të vendimit pranë AK-së, kurse autoritet kontraktues me datë 07.02.2020 e aprovon kërkesën e OE “Rexha” si të bazuar, duke e anuluar njoftimin për dhënie të kontratës. Arsytet e aprovimit të kërkesës për ri shqyrtim të OE “Rexha” dhe eliminimin nga gara të OE ankues “Beni Com”, “Linda”, “Euro Infrastruktura” ishin:

- OE ankues “Beni Com”, “Linda”, “Euro Infrastruktura” nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, punë për ndërtim dhe rregullim të parqeve, shesheve dhe hapësirave tjera publike në 3 (tri) vitet e fundit në vlerë minimale prej 800.000,00€.

Lidhur me këtë arsye të eliminimi, Paneli Shqyrtues konsideron se në ofertën e OE ankues gjenden kontrata me referenca për këtë kriter, mirëpo këto referenca janë kryesisht me shtrimin e asfaltit kurse AK ka kërkuar në dosje të tenderit, me saktë “seksioni II Fleta e të dhënave të tenderit”, “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1&9.2 – është kërkuar:

“Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, punë për ndërtim dhe rregullim të parqeve, shesheve dhe hapësirave tjera publike, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 800.000,00 euro. SHENIM Nëse tenderuesi është grup i OE-it lideri i grupit duhet të plotësojë 60 % të vlerës së referencave”.

Ndërsa, grupi i OE ankues “Beni Com”, “Linda”, “Euro Infrastruktura” për këtë kërkesë të dosjes së tenderit ka bashkangjitur kontrata që kanë të bëjnë me “shtrimin e asfaltit” dhe nuk kanë të bëjnë me rregullim të parqeve apo të natyrës së ngjashme. Andaj, ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë të OE ankues “Beni Com”, “Linda”, “Euro Infrastruktura” se AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së duke mos i trajtuar në mënyrë të barabartë dhe duke vepruar në mënyrë jo të drejtë dhe jo diskriminuese duke anuluar vendimin e datës 31.01.2020 me të cilin AK e kishte shpallur fitues grupin e OE “Beni Com”, “Linda”, “Euro Infrastruktura”, me arsyetimin se përveç që nuk plotëson si lider 60% të punimeve të ngjashme, ka të punësuar edhe një punonjës inxhinier Safet Lipovica që ka marrë pjesë në një aktivitetin e prokurimit me numër 616 118 094 221 dhe të njëjtin e ka quajtur konflikt interesi. OE ankues vazhdon të pretendoj se OE i rekomanduar për kontratë “Rexha” Sh.p.k. i cili në tri

vitet e fundit 2016-2017-2018 ka paraqitur punëtorin inxhinier Naser Surdulli arkitekt, i cili po ashtu ka punuar në të njëjtin aktivitet të prokurimit me punonjësin e OE “Beni Com”. Pra, në të njëjtin aktivitet prokurimi me numër 616 118 094 221 kanë qenë të angazhuar inxhinier Safet Lipovica dhe inxhinier Naser Surdulli, ku ky i fundit ka qenë i punësuar pranë OE “Rexha” Sh.p.k. në vitet 2016, 2017 dhe 2018. OE ankues pretendon se lidhur me këta dy inxhinier, AK ka përdor standarde të dyfishta duke mos i trajtuar në mënyrë të barabartë këta dy operator ekonomik.

Paneli Shqyrtues konform eksperteve shqyrtuese sqaron se pretendimi i OE ankues lidhur inxhinierët Safet Lipovica dhe Naser Surdulli, ky pretendim është i bazuar sepse në vendimin e AK-së të datës 07.02.2020 ku janë bashkangjitur dokumentet e hartimit të projektit, më saktë tek shtojca me emrin “vendimi i projektuesit” shihet që Safet Lipovica dhe Naser Surdulli kanë punuar në të njëjtin projekt. Konkretisht, Safet Lipovica në cilësi të inxhinierit të ndërtimtarisë për fazën e strukturës, kurse Naser Surdulli në cilësi të inxhinierit të arkitekturës. Të dy inxhinierët, Safet Lipovica dhe Naser Surdulli kanë punuar në hartimin e projektit në fjalë që ka të bëjë me aktivitetin e prokurimit me numër 616-18-094-2-2-1. Kurse, në realizim të projektit apo si fazë e dytë, është ky aktivitet i prokurimit “Ndërtimi i parkut rekreativ-sportiv në Dardani dhe renovimi i hapësirës” me numër 616-19-763-5-1-1.

Lidhur me pretendimin e tretë ankimor të grupit të operatorëve ekonomik ankues “Beni Com”, “Linda”, “Euro Infrastruktura” se AK ka shkelur nenin 52 të LPP-së duke diskualifikuar grupin e OE ankues “Beni Com”, “Linda”, “Euro Infrastruktura” me arsyetimin se nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se kanë përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, punë për ndërtim dhe rregullim të parqeve, shesheve dhe hapësirave publike në 3 vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë në vlerë minimale 800,000.00 euro, duke qenë se tenderuesi është grup, lideri i grupit duhet të plotësojë 60% të vlerës së referencave. Për këtë pretendim, grupi i OE ankues shton se kontrata të ngjashme (hapësirave publike), operatori Beni Com ka përfunduar rrugë si lider i punimeve:

- “Rregullimi i qendrës së qytetit faza 2 segmenti 1.2.3” – lokacioni i këtij projekti është sheshi para komunës së Ferizajt në vlerë 243,607.53 euro, bashkëlidhur gjeni raport për projektin Nr.05 i datës 07.08.2018 nga AK Komuna e Ferizajt, si dhe fotot e vendit të ngjarjes së këtij projekti.

- “Asfaltimi i rrugës te Xhamia në Podujevë me infrastrukturë përcjellëse, ndriçim publik, kanalizim fekal, kanalizim atmosferik, rrjeti i ujësjellësit, sinjalizim horizontal e vertikal, urën mbi lumin Llap afër Kompleksit “Malësia” – lokacioni i këtij projekti është rreth lumit Llap në qendrën e qytetit të Podujevës në vlerë prej 293,871.53 euro, bashkëlidhur gjeni raportin preliminar i pranimi teknik të punëve të kryera i datës 17.12.2019 nga AK Komuna e Podujevës, si dhe fotot e vendit të ngjarjes së këtij projekti.

Në vazhdim të pretendimit të njëjtë, grupi i OE ankues pretendon se sipas llogaritjeve të këtyre dy aktiviteteve të prokurimit, OE “Beni Com” Sh.p.k. ka të përfunduara si lider vlerën e punimeve 537,476.06 euro. E që sipas dosjes së tenderit duhet ti ketë 60% të punimeve si lider i grupit të operatorëve ekonomik që në vlerë i bie se duhet të ketë 480,000.00 euro punime me kontrata të ngjashme. Paneli Shqyrtues sqaron se për këtë pretendim ankimor ka dhënë përgjigje tek pretendimi i parë që ka të bëjë me referencat dhe kontratat. Pra, ngjashëm sikurse pretendimi i parë edhe ky pretendim është pjesërisht i bazuar sepse OE ankues në e-mailin e dërguar me datë 22.05.2020 ka bashkangjitur një dokument të skanuar, ku në këtë dokument janë disa kontrata dhe referenca me të cilat dëshmohet se e plotëson kriterin e dosjes së tenderit që lideri i grupit duhet ti ketë 60% të punimeve me kontrata të ngjashme. Megjithatë, për Panelin Shqyrtues është e paqartë nëse këto kontrata janë të ngjashme sikurse ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit.

Lidhur me pretendimin e katërt ankimor të grupit të operatorëve ekonomik ankues “Beni Com”, “Linda”, “Euro Infrastruktura” se AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së duke e shpallur fillimisht fitues grupin e OE ankues dhe duke e konsideruar si grup më të përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët në këtë aktivitet të prokurimit dhe për këtë arsye konsiderojmë se AK ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues konsideron se ky pretendim është pjesërisht i bazuar për shkak se OE ankues ka dëshmuar që përmbush kriterin që ka të bëjë me referenca apo pranime teknike në shumën e caktuar. Por, AK me qëllim të ekzaminimit dhe krahasimit sa më të drejtë të tenderëve do duhej të sqaronte nëse këto kontrata, referenca janë të natyrës së ngjashme sikurse është kërkuar në dosje të tenderit.

Lidhur me pretendimin e pestë të grupit të operatorëve ekonomik ankues “Beni Com”, “Linda”, “Euro Infrastruktura” se AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së duke mos e shpërblyer me kontratë grupin e OE ankues, i cili ka ofertuar me vlerën më të ulët në këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli Shqyrtues konsideron se edhe ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar për shkak se nëse OE ankues ka kontrata të ngjashme do të rezultonte me shkeljen e nenit 60 të LPP-së pasi që oferta e OE ankues është me çmim më të lirë në shumë prej 62,274.94 euro se oferta e OE të rekomanduar për kontratë.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe atyre të dërguara përmes postës elektronike të datës 22.05.2020 vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk e ka bërë ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së nga OE ankues lidhur me natyrën e punëve të cilat i ka dëshmuar përmes referencave, duke pasur parasysh kërkesat e

përcaktuara në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë. Pas sqarimit të këtyre kontratave dhe referencave për natyrën e punëve të kryera nga OE ankues e për të cilat ka bashkangjitur këto referenca, AK të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve në pajtim me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- "KK-Prishtinë",

1x1 OE - "Beni-Com" SH.P.K, "Linda" SH.P.K.; "Euro Infrastruktura" – Obiliq,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.